



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 mars 2021
Nr. ref.:RK1721/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI132/19

Parashtrues

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ARJ-
UZVP. nr. 72/2018 të 16 prillit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Jusuf Gërguri, jurist.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP. nr. 72/2018] të 16 prillit 2019, të cilin e ka pranuar më 6 maj 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 21 paragrafi 4 dhe nenin 113 paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 gusht 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka Nimani (anëtare).
7. Më 6 shtator 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe me anë të këtij njoftimi, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë një kopje të fletëkthesës se kur i ishte dorëzuar Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 72/2018] i Gjykatës Supreme të 16 prillit 2019.
8. Më 6 shtator 2019, Gjykata në pajtim me ligjin dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.
9. Më 19 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën për dorëzimin e Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 72/2018] të Gjykatës Supreme, me datën e dorëzimit 6 maj 2019.
10. Më 3 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura administrative (jashtëgjyqësore)

11. Më 13 mars 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Mitrovicës kërkesë për regjistrimin e disa pronave të paluajtshme, ndër të tjera edhe pronat e paluajtshme me numër të parcelave nr. 1413, nr. 1415, nr. 1416 dhe nr. 1837/1, ZK-Mitrovicë.
12. Më 21 maj 2015, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër me vendimin [nr. 17922/14] e aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit në mënyrë të tillë që kërkesa për regjistrimin e parcelave individuale të pranohej ndërsa kërkesa për regjistrimin e ngastrave kadastrale nr. 1413, 1415, 1416 dhe 1837, është refuzuar me arsyetimin se objektet e planifikuara për ndërtim në parcelat e kontestuar nuk ishin ndërtuar siç kërkohej me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 12/168 të 29 janarit 2014. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
13. Më 5 nëntor 2015, Agjencia Kadastrale e Kosovës me Vendimin [nr. 03/2150/15] refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin [nr. 17922/14] të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Mitrovicës të 21 majit 2015. Agjencia Kadastrale e Kosovës deklaroi në vendim se pasi gjeometrat dolën në terren, u vërtetua se nuk kishte pajisje energjetike të instaluar në parcelat e kontestuar, prandaj, si pasojë, nuk është e mundur të bëhet regjistrimi i së drejtës për shfrytëzimin e parcelave të kontestuar për 99 vjet, siç parashihej me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 12/168 të 29 janarit 2014.

Procedura administrative (kontesti administrativ)

14. Më 24 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, duke kërkuar anulimin e vendimit [nr. 17922/14] të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe aktvendimit [nr. 03/2150/15] të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
15. Më 18 tetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin [A. nr. 2017/2015] refuzoi, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin [nr. 17922/14] të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe aktvendimin [nr. 03/2150/15] e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Në arsyetimin e vendimit thuhet, "*paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për regjistrimin e parcelave kadastrale të lartshënuara, kjo për faktin se në të njëjtat nuk kanë qenë të vendosura stabilimentet energjetike, kusht dhe kriter ky në bazë të të cilit edhe u është e drejta e servitutit, shfrytëzimit si dhe të drejtat tjera pronësore për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 12/168, të dt. 29.01.2014. Në kuptim të dispozitave të lartëcituarra të Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, përkatësisht nenit 3 par 3.4 të të njëjtit, paditësi nuk i ka plotësuar kërkesat për regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme të kërkuar*".

16. Më 13 nëntor 2017, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit [A. nr. 2017/2015] të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 18 tetorit 2017, *“për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK-së, Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
17. Më 19 shtator 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [AA. nr. 547/2017] refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin [A. nr. 2017/2015] e Gjykatës Themelore të 18 tetorit 2017.
18. Më 8 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të gjykatës kundër aktgjykimit [A. nr. 2017/2015] të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe aktgjykimit [AA. nr. 547/2017] të Gjykatës së Apelit, *“për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe shkeljes së zbatimit të së drejtës materiale”*.
19. Më 16 prill 2019, Gjykata Supreme, me aktgjykimin [ARJ-UZVP. nr. 72/2018] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon që me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrotjtja e Pronës], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
21. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon *“se gjykatat e rregullta nuk kanë vepruar komfor dispozitave ligjore të cilat rregullojnë çështjen: [Të Drejtat Pronësore të Ndërmarrjeve të Energjisë], kreu VIII të Ligjit për Energji nr. 03/L – 184 i datës 07 tetor 2010, përkatësisht nenit 24 paragrafi 1 dhe 2.*
22. Parashtruesi i kërkesës në thelb arsyeton shkeljen e neneve të sipërpërmendura të Kushtetutës, duke pretenduar shkeljen, *“e Ligjit për Energji, përkatësisht nenit 24 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 11”*.
23. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që,

“I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje nenit 102 par. 5 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, nenit 46 i Kushtetutës së Kosovës lidhur me mbrotjtjen e pronës si dhe nenit 24 paragrafi 1 dhe 2, nenit 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11. i Ligjit për Energji nr. 03/L – 184;

III. TË KONSTATOJ se Kërkesa për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimeve Gjyqësore e datës 10.10.2018 i parashtrueses së kërkesës -

paditëses i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë ARJ-UZVP. nr. 72/2018 i datës 16.04.2019, është e bazuar;
IV. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP. nr. 72/2018 i datës 16.04.2019;
V. TA KTHEJË Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 72/2018 i datës 16.04.2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës për rishqyrtim”.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 2002/5
Për krijimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme
të 17 tetorit 2002
[...]

Neni 3
Regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme

[...]

3.2 Parashtruesi që kërkon regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme, kërkesës duhet t’ja bashkangjes dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij ligji.

[...]

3.7 Pa prejudikuar nenin 1.2 (b) të Rregullores Nr. 1999/23, të UNMIK-ut (mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje pronësore-banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore-banesore) ZKK-ja do të regjistrojë të drejtën e pronës së paluajtshme në Regjistër vetëm nëse gjykata kompetente i ka dhënë dokumentin përkatës me shkrim ZKK-së për regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme në Regjistër.

Udhëzimi Administrativ
MSHP Nr. 2004/03
Për zbatimin e ligjit mbi themelimin e regjistrit për të drejtat në
pronën e paluajtshme i 31 marsit 2004
[...]

Neni 5

Baza Ligjore për Regjistrim

5.1 Regjistrimi i një të drejte mbi pronën e paluajtshme mund të bazohet në:

- i. Dokument valid nga një organ kompetent (gjyqësor ose administrativ).
- ii. Vendim përfundimtar nga gjykata kompetente.
- iii. Me një transaksion ligjor, që përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi.

VENDIMI
i Qeverisë së Republikës së Kosovës
Nr. 12/168
i 29.01.2014

[...]

1. *Ndërmarrjeve të Energjisë të ju jepen formalisht e drejta e servitutit, shfrytëzimit ose të drejtat tjera pronësore për 99 (nëntëdhjetënëntë) vite, ku Ndërmarrjet e Energjisë i kanë të vendosura stabilimentet energjetike, për të cilat prona nuk kanë të siguruar formalisht të drejta pronësore në pajtim me Legjislacionin në fuqi.*
2. *Të drejtat pronësore të dhëna Ndërmarrjeve të Energjisë sipas Ligjit për Energji para se të regjistrohen në Zyrat Kadastrale Komunale, duhet të përgatitet elaborati i matjeve kadastrale për ato njësi kadastrale ku janë të vendosura stabilimentet energjetike.*
3. *Matjet kadastrale të cilat do të përcaktojnë kufirin përfundimtar të parcelës ku ndodhet stabilimenti apo objekti energjetik duke siguruar përdorim normal dhe të rregullt të stabilimentit energjetik duhet të jenë në pajtim me legjislacionin kadastral në fuqi (udhëzimet administrative dhe korniza për punë praktike) dhe legjislacionin tjetër në fuqi.*
4. *Zyrat Kadastrale Komunale rekomandohen që të shqyrtojnë të gjitha kërkesat e Ndërmarrjeve të Energjisë dhe të regjistrojnë të drejtat e tyre përkatëse të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.*
5. *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113 i Kushtetutës
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj “.

[...]

Neni 21 i Kushtetutës
[Parimet e përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

26. Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, siç parashihet me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afati]

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

27. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese duke iu referuar shkeljes së pretenduar të të drejtave dhe lirive kushtetuese, që vlejné si për individët ashtu edhe për personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010).
28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e një autoriteti publik, përkatësisht aktgjykimin [ARJ-UZVP.

nr. 72/2018] të Gjykatës Supreme të 16 prillit 2019, duke theksuar qartë nenet e Kushtetutës të cilat ai konsideron se janë shkelur, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë cenuar, në pajtim me kërkesat nga neni 48 i Ligjit si dhe e ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

29. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar me rregullin 39 (2) Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
31. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).
32. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

33. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur (i) neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], , neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe(ii) neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës.
34. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës përsërit argumentet e njëjta që ai paraqiti në procedurat para Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës së Komunës së Mitrovicës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si dhe pranë gjykatave të rregullta, që Gjykata Supreme është marrë me këtë çështje, kështu që në paragrafët vijues Gjykata do të shtjellojë më tej procedurat e zhvilluara pranë gjykatave të rregullta.
35. Kur bëhet fjalë për shkeljet e lartpërmendura të të drejtave të garantuara me nenin 3, 31, 46, 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së etabluar të GJEDNJ-së, Gjykata shpall një kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet njëri nga dy kushtet karakteristike, konkretisht:
- a) kur parashtuesi i kërkesës vetëm përmend një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se në çfarë mënyre janë shkelur ato, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit shkelja është krejtësisht e qartë (shih lidhur me këtë, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës* (Vendim) nr. 4241/03 i 31 majit 2005, gjithashtu shih *Baillard kundër Francës* (Vendim)) nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008).
 - b) kur parashtuesi i kërkesës dështon ose refuzon të paraqesë prova materiale me të cilat do të mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose autoriteteve tjera vendëse), përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe që e parandalojnë të bëjë një gjë të tillë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’i dorëzojë Gjykatës dokumentet e dosjes së një të burgosuri) ose nëse vetë Gjykata nuk përcakton ndryshe.
- (i) Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës**
36. Në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës vetëm pretendon shkelje të neneve 3, 31, 54 dhe 102 të Kushtetutës por të njëjtën nuk e arsyeton dhe nuk shpjegon se si janë shkelur këto nene.
37. Prandaj, sa i përket këtyre pretendimeve të parashtuesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 31, 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se këtë pjesë të kërkesës duhet ta shpallë të papranueshme si qartazi të pabazuar pasi që këto pretendime kualifikohen si pretendime që hynë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”

pasi që parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar me atë rast se në çfarë mënyre janë shkelur ato. Rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

38. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën në pronë, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme [me aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 72/2018] vërtetoi që për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të parapara me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 12/168, të 29 janarit 2014, nuk ishte e mundur të regjistrohej e drejta e parashtruesit për shfrytëzimin e parcelave të kontestuara për një periudhë prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vitesh.
39. Gjykata gjithashtu vëren se në lidhje me pretendimet e parashtruesit përkitazi me të drejtën e pronës, Gjykata Supreme iu përgjigj parashtruesit të kërkesës duke argumentuar se me vendimin e Qeverisë ishte vendosur (i) t'u jepet Ndërmarrjeve të Energjisë e drejta e servituteve, shfrytëzimin ose të drejtat e tjera pronësore për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, për pronat ku Ndërmarrjet e Energjisë kanë instaluar stabilimente energjetike; (ii) që pasi gjeometri doli në terren, u konstatua që asnjë stabiliment energjetik nuk ishte vendosur në parcelat e kontestuara; dhe se (iii) si rezultat i kësaj, nuk ishte e mundur të regjistrohej e drejta për të shfrytëzuar parcelat e kontestuara për një periudhë prej 99 vjetësh, bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës, [nr. 12/168 të 29 janarit 2014], sepse nuk ishin plotësuar kushtet për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme në kuptim të dispozitave të Ligjit nr. 2002/05 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 2004/3.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se në pajtim me legjislacionin përkatës si dhe vetë përmbajtjen e vendimit të Qeverisë [nr. 12/168], gjykatat e rregullta dhe në veçanti Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi i kërkesës për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të përcaktuara me vendimin e Qeverisë nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për regjistrimin e të drejtave mbi pronën e kontestuar.
41. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së nuk garantojnë të drejtën për fitimin e pronës (shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983; *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 9 tetorit 2003).
42. Më tej, parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pasurinë” e tij. Brenda kuptimit të kësaj dispozite „pasuria“ mund të jetë „pasuria ekzistuese“, duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë „pritshmëri legjitime“ që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.
43. Nuk mund të thuhet se lind ndonjë „pritje legjitime“ atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së

brendshme dhe atje ku parashtruesat e parashtruesve janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 2004).

44. Prandaj, sa i përket këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata konstaton se këtë pjesë të kërkesës duhet ta shpallë të papranueshme si qartazi të pabazuar pasi që këto pretendime kualifikohen si pretendime që hynë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” pasi që parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar me atë rast se në çfarë mënyre i janë shkelur ato parashtruesit të kërkesës dhe nuk ka dorëzuar prova materiale me të cilat do të mbështeste pretendimet për shkelje të së drejtës së pronës. Rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

45. Prandaj, sa i përket këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 31, 46, 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se kërkesën në tërësi duhet ta shpallë të papranueshme si qartazi të pabazuar pasi që këto pretendime të parashtruesit kualifikohen si pretendime që hynë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 3 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi